

## TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

Vendi Aderues: Shqipëria

<b>DIREKTIVË 2012/28/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, DATË 25.10.2012, "PËR PËRDORIME TË CAKTUARA TË LEJUARA TË VEPRAVE PA AUTOR"</b>  (Tekst i cili lidhet me ZEE)		Legjislacioni i Vendit Aderues  <b>LIGJI Nr. 35 / 2016 MBI TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E LIDHURA ME TË</b>				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Përmbajtja	Përputhshmeria	Shënime

<b>A 1</b>	<b>Objekti dhe fusha e zbatimit</b>  1. Direktiva ka të bëjë me disa mënyra përdorimi të veprave pa autor nga bibliotekat me akses publik, institucionet arsimore dhe muzetë, si dhe nga arkivat, institucionet e trashëgimisë filmike ose zanore dhe ofruesit publik të shërbimit mediatic audioviziv që ndodhen në shtetet anëtare, për të arritur synimet në lidhje me misionet e tyre në interes të publikut.		<b>A 75/1</b>  <b>A 16/1</b>	<b>Përdorimi pa kufizim i veprave pa autor</b>  1. Bibliotekat publike, institucionet arsimore ose muzetë, personat e tjerë juridikë që kryejnë veprimtari muzeore, arkivat, institucioneve arkivore filmike ose audiovizuale dhe Ofruesit e shërbimit mediatic audiovizual (OSHMA-t) që janë krijuar në Republikën e Shqipërisë mund të riprodhojnë vepra pa autor që janë të përfshira në koleksionet e tyre për qëllime të dixhitalizimit, si dhe duke i vendosur ato në dispozicion të publikut, të indeksuara, kataloguara, ruajtura ose restauruara.  <p style="text-align: center;"><b>Veprat pa autor</b></p> 1. “Vepër pa autor” konsiderohet vepra kur, pas kryerjes dhe dokumentimit të një kërkimi shterues në kuptim të nenit 16/2, asnjë nga autorët ose bashkëautorët e një vepre nuk është identifikuar, nëse autori ose një a më shumë bashkëautorë të veprës janë identifikuar por asnjërit prej tyre nuk i dihet vendndodhja. 2. Nëse, pas kryerjes dhe dokumentimit të kërkimit shterues në kuptim të këtij ligji, jo të gjithë bashkëautorët e një vepre janë identifikuar ose nëse janë identifikuar dhe u dihet vendndodhja, zbatohet neni 75/1 dhe 75/2, i këtij ligji. Kjo pikë e këtij neni zbatohet vetëm nëse të gjithë bashkëautorët e identifikuar dhe që u dihet adresa kanë lëshuar autorizimin e tyre për riprodhimin dhe vënien në	<b>Plotë</b>
------------	---	--	------------------------------------	---	--------------

A = Neni; P= Paragrafi; S= Fjalja; N= Numri;  
 F= Përputhje e plotë; P= Përputhje e pjesëshme; N= Mos përputhje

## TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

Vendi Aderues: Shqipëria

<b>DIREKTIVË 2012/28/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, DATË 25.10.2012, "PËR PËRDORIME TË CAKTUARA TË LEJUARA TË VEPRAVE PA AUTOR"</b>  (Tekst i cili lidhet me ZEE)		Legjislacioni i Vendit Aderues  <b>LIGJI Nr. 35 / 2016 MBI TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E LIDHURA ME TË</b>				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Përmbajtja	Përputhshmeria	Shënime

	<p style="text-align: center;">2. Kjo direktivë zbatohet për:</p> <p>a) veprat e botuara në formë librash, revistash, gazetash ose shkrime të tjera të përmbajtura në koleksionet e bibliotekave me akses publik, institucionet arsimore dhe muzetë, si dhe në arkiva, institucione të trashëgimisë filmike ose zanore dhe në ofruesit publik të shërbimit mediatik audioviziv;</p> <p>b) veprat kinematografike ose audiovizuale dhe fonogramet e përfshira në koleksionet e bibliotekave me akses publik, institucioneve arsimore dhe të muzeve, si dhe në koleksionet e arkivave ose të institucioneve të trashëgimisë filmike ose zanore; dhe</p> <p>c) veprat kinematografike ose audiovizuale dhe fonogramet e prodhuara nga ofruesit publik të shërbimit mediatik audioviziv, deri më 31 dhjetor 2002, që përmbahen në</p>			<p>dispozicion të publikut për një vepër të tillë, sipas parashikimeve të nenit 75/1 të këtij ligji. Të drejtat e bashkëautorëve të identifikuar dhe që u dihet vendodhja do të mbeten të pa cenuara</p> <p>3. Pika 1 dhe 2 e këtij neni zbatohen për:</p> <p>a) vepra të botuara në formën e librave, gazetave, revistave ose shkrimeve të tjera të përfshira në koleksionet e bibliotekave që janë të aksesueshme nga publiku, të institucioneve arsimore dhe muzeve, të personave të tjerë juridikë që kryejnë veprimtari muzeore, si dhe në koleksionet e arkivave ose të institucioneve arkivore filmike ose audiovizuale;</p> <p>b) veprat kinematografike ose vepra të tjera audiovizuale të përfshira në koleksionet e institucioneve që janë të aksesueshme nga publiku, të institucioneve arsimore dhe muzeve, të personave të tjerë juridikë që kryejnë veprimtari muzeore, si dhe në koleksionet e arkivave ose të institucioneve arkivore filmike ose audiovizuale;</p> <p>c) veprat kinematografike ose vepra të tjera audiovizuale të prodhuara nga Ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA) deri në 31 dhjetor 2002 të cilat janë të mbrojtura nga e drejta e autorit dhe që gjenden në arkivat e tyre publikohen për herë të parë në Republikën e Shqipërisë ose, në mungesë të publikimit, transmetohen për herë të parë në Republikën e Shqipërisë.</p>		
--	---	--	--	--	--	--

A = Neni; P= Paragrafi; S= Fjalja; N= Numri;  
F= Përputhje e plotë; P= Përputhje e pjesëshme; N= Mos përputhje

## TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

Vendi Aderues: Shqipëria

<b>DIREKTIVË 2012/28/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, DATË 25.10.2012, "PËR PËRDORIME TË CAKTUARA TË LEJUARA TË VEPRAVE PA AUTOR"</b>  <b>(Tekst i cili lidhet me ZEE)</b>		Legjislacioni i Vendit Aderues  <b>LIGJI Nr. 35 / 2016 MBI TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E LIDHURA ME TË</b>				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Përmbajtja	Përputhshmeria	Shënime

	<p>arkivat e tyre;</p> <p>të cilat mbrohen nga e drejta e autorit ose të drejta të lidhura dhe që janë botuar për herë të parë në një shtet anëtar ose, nëse nuk janë botuar, që janë transmetuar për herë të parë në një shtet anëtar.</p> <p>3. Direktiva gjithashtu zbatohet për veprat dhe fonogramet e përmendura në paragrafin 2, që nuk janë botuar apo transmetuar asnjëherë, por që vihen në akses publik nga ofruesit publik të shërbimit mediatic audioviziv të përmendur në paragrafin 1, me pëlqimin e titullarëve, në rastin kur është e arsyeshme të mendohet se titullarët nuk kanë kundërshtim për përdorimet e përmendura në nenin 6. Shtetet anëtare mund të kufizojnë zbatimin e këtij paragrafi vetëm mbi vepra dhe fonograme që janë depozituar pranë këtyre ofruesve publik të shërbimit mediatic audioviziv përpara 29 tetorit 2014.</p> <p>4. Direktiva zbatohet dhe për vepra dhe materiale të tjera të mbrojtura të integruara ose të trupëzuara, ose që janë pjesë përbërëse të veprave apo të</p>			<p>4. Pika 1 dhe 2 të këtij neni zbatohen gjithashtu për veprat e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, të cilat nuk janë publikuar ose transmetuar ndonjëherë, por që për herë të parë janë bërë të njohura në publik nga bibliotekat që aksesohen nga publiku, institucionet arsimore ose muzetë, persona të tjerë juridikë që kryejnë veprimtari muzeore, arkivat, institucionet institucioneve arkivore filmike ose audiovizuale dhe ofruesit e shërbimit mediatic audioviziv OSHMA, krijuar në Republikën e Shqipërisë, vetëm me pëlqimin e autorëve, me kushtin që, në mënyrë të arsyeshme, të mendohet se autorët e këtyre veprave nuk do të kundërshtonin përdorimin e referuar në nenin 75/1 dhe 75/2, të këtij ligji.</p> <p>5. Pika 1 dhe 2 të këtij neni do të zbatohen gjithashtu për veprat që janë përfshirë trupëzuar/, integruar ose që janë pjesë përbërëse e veprave të përmendura në pikat 3 dhe 4 të këtij neni.</p> <p>8. Prezumimi i autorësisë tek veprat pa autor dhe ushtrimi i së drejtës së autorit, anonim apo pseudonim, zbatohet për sa kohë nuk bie në kundërshtim me parashikimet e këtij neni.</p> <p style="text-align: center;"><b>E drejta e kompesimit për përdorimin e veprës pa</b></p>		
--	--	--	--	--	--	--

A = Neni; P= Paragrafi; S= Fjalja; N= Numri;

F= Përputhje e plotë; P= Përputhje e pjesëshme; N= Mos përputhje

## TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

Vendi Aderues: Shqipëria

<b>DIREKTIVË 2012/28/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, DATË 25.10.2012, "PËR PËRDORIME TË CAKTUARA TË LEJUARA TË VEPRAVE PA AUTOR"</b>  <b>(Tekst i cili lidhet me ZEE)</b>		Legjislacioni i Vendit Aderues  <b>LIGJI Nr. 35 / 2016 MBI TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E LIDHURA ME TË</b>				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Përmbajtja	Përputh shmeria	Shënime

	fonogrameve të përmendura në paragrafët 2 dhe 3.  5. Direktiva nuk ndërhyr në masat që kanë të bëjnë me administrimin e të drejtave në nivel kombëtar.		<b>A 75/2</b>	<p style="text-align: center;"><b>autor</b></p> 5. Dispozitat e këtij neni nuk do të ndikojnë në të drejtat dhe detyrimet e fituara nga dispozitat tjera ligjore në lidhje me të drejtat e tjera të pronësisë intelektuale, aksesin e kushtëzuar, aksesin në shërbimet e transmetimit me kabëll, mbrojtjen e thesareve kombëtare, kërkesat për depozitimet, arkivimet ligjore të veprave, mbrojtja e tregtinë së lire, ligjet antitrust, sekretet tregtare, sigurinë, konfidencialitetin, mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë, aksesin në dokumente publike, legjislacionin përkatës për marrëdhëniet kontraktuale dhe rregullat për lirinë e shtypit dhe shprehjes në media.”.		
<b>A 2</b>	<b>Veprat pa autor</b>  1. Vepra ose fonogrami konsiderohet vepër pa autor nëse nuk identifikohet asnjë prej titullarëve të veprës ose të fonogramit, ose edhe kur identifikohen një a më shumë prej tyre, nuk pikaset dot asnjëri pavarësisht kryerjes së kërkimi të kujdesshëm në përputhje me nenin 3.  2. Kur ka një a më shumë titullarë në një vepër apo fonogram, dhe		<b>A 16/1</b>	<b>Veprat pa autor</b>  1. “Vepër pa autor” konsiderohet vepra kur, pas kryerjes dhe dokumentimit të një kërkimi shterues në kuptim të nenit 16/2, asnjë nga autorët ose bashkëautorët e një vepre nuk është identifikuar, nëse autori ose një a më shumë bashkëautorë të veprës janë identifikuar por asnjëri prej tyre nuk i dihet vendndodhja.  2. Nëse, pas kryerjes dhe dokumentimit të kërkimit shterues në kuptim të këtij ligji, jo të gjithë bashkëautorët e një vepre janë identifikuar ose nëse	<b>Plotë</b>	

A = Neni; P= Paragrafi; S= Fjalja; N= Numri;

F= Përputhje e plotë; P= Përputhje e pjesëshme; N= Mos përputhje

## TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

Vendi Aderues: Shqipëria

<b>DIREKTIVË 2012/28/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, DATË 25.10.2012, "PËR PËRDORIME TË CAKTUARA TË LEJUARA TË VEPRAVE PA AUTOR"</b>  <b>(Tekst i cili lidhet me ZEE)</b>		Legjislacioni i Vendit Aderues  <b>LIGJI Nr. 35 / 2016 MBI TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E LIDHURA ME TË</b>				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Përmbajtja	Përputh shmeria	Shënime

	<p>asnjë prej tyre nuk është identifikuar, apo edhe kur është identifikuar, nuk është pikasur pas një kërkimi të kujdesshëm dhe regjistrimi në përputhje me nenin 3, vepra ose fonogrami mund të përdoret në përputhje me këtë direktivë nëse titullarët që janë identifikuar dhe pikasur, për sa u përket të drejtave që mbajnë, i kanë autorizuar ofruesit e shërbimit mediatic të përmendur në nenin 1, paragrafi 1 të kryejnë veprimet e riprodhimit dhe të vënies në dispozicion të publikut përkatësisht sipas neneve 2 dhe 3 të Direktivës 2001/29/KE.</p> <p>3. Paragrafi 2 nuk cenon të drejtat e veprës ose të fonogramit të titullarëve që janë identifikuar dhe pikasur.</p> <p>4. Neni 5 zbatohet rast pas rasti për titullarët e paidentifikuar dhe të papikasur në veprat e përmendura në paragrafin 2.</p> <p>5. Direktiva nuk cenon dispozitat kombëtare për veprat anonime ose nën pseudonime.</p>			<p>janë identifikuar dhe u dihet vendndodhja, zbatohet neni 75/1 dhe 75/2, i këtij ligji. Kjo pikë e këtij neni zbatohet vetëm nëse të gjithë bashkëautorët e identifikuar dhe që u dihet adresa kanë lëshuar autorizimin e tyre për riprodhimin dhe vënien në dispozicion të publikut për një vepër të tillë, sipas parashikimeve të nenit 75/1 të këtij ligji. Të drejtat e bashkëautorëve të identifikuar dhe që u dihet vendndodhja do të mbeten të pa cenuara.</p> <p>8. Presumimi i autorësisë tek veprat pa autor dhe ushtrimi i së drejtës së autorit, anonim apo pseudonim, zbatohet për sa kohë nuk bie në kundërshtim me parashikimet e këtij neni.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

A = Neni; P= Paragrafi; S= Fjalja; N= Numri;

F= Përputhje e plotë; P= Përputhje e pjesëshme; N= Mos përputhje

## TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

Vendi Aderues: Shqipëria

DIREKTIVË 2012/28/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, DATË 25.10.2012, "PËR PËRDORIME TË ÇAKTUARA TË LEJUARA TË VEPRAVE PA AUTOR"  (Tekst i cili lidhet me ZEE)		Legjisllacioni i Vendit Aderues				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Përmbajtja	Përputhshmeria	Shënime

A 3	<b>Kërkimi i kujdesshëm</b>  1. Për qëllimet e përcaktimit nëse vepra ose fonogrami është vepër pa autor, ofruesit e shërbimit mediatik të përmendur të nenin 1, paragrafi 1 sigurojnë kryerjen e kërkitimit të kujdesshëm, në mirëbesim dhe në respekt të secilës vepër ose material tjetër të mbrojtur, përmes konsultimit me burimet e përshtatshme për kategoritë e veprave dhe të materialeve të tjera të mbrojtura në fjalë. Kërkimi i kujdesshëm zhvillohet përpara përdorimit të veprës ose të fonogramit.  2. Burimet që janë të përshtatshme për secilën kategori të veprave ose të fonogramit në fjalë përcaktohen nga secili shtet anëtar, në konsultim me titullarët dhe përdoruesit, dhe përfshin së paku burimet përkatëse të përmendura në shtojcë.  3. Kërkimi i kujdesshëm kryhet në shtetin anëtar të botimit të parë ose, nëse nuk ka botim, të transmetimit të parë, përveç rastit të veprave kinematografike ose audiovizuale	A 16/2	<b>Kërkimi shterues me qëllim dhënien e statusit të veprave pa autor dhe dokumentimi i informacionit</b>  1. Bibliotekat me akses publik, institucionet arsimore ose muzetë, personat e tjerë juridikë që kryejnë veprimtari muzeore, arkivat, institucionet arkivore filmike ose audiovizuale dhe ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA-t) që janë krijuar në Republikën e Shqipërisë, për qëllimin e identifikimit ose gjetjes së vendodhjes së autorëve ose bashkëautorëve ose dhënies së statusit të veprave pa autor, respektivisht, kryejnë në mirëbesim një kërkim shterues për çdo vepër. Kërkimi shterues kryhet përpara përdorimit të veprës, duke kërkuar tek burimet që janë të përshtatshme për kategorinë përkatëse të veprave.  2. Në rast se evidentohet që informacioni përkatës mbi mbajtësit e të drejtës gjendet në shtete të tjera, kërkimi shterues, për aq sa është e mundur do të shtrihet edhe tek burimet e informacionit që gjenden në ato shtete.	<b>Plotë</b>	
A 16/3		<b>Burimet e kërkitimit shterues</b>  1. Burimet e përshtatshme sipas këtij neni janë: a) Për librat e botuar: i. Depozitimet e kopjeve të detyruara, në veçanti i bibliografisë kombëtare, katalogëve të bibliotekave, leksioneve biografike, të dosjeve dhe të			

A = Neni; P= Paragrafi; S= Fjalë; N= Numri;

F= Përputhje e plotë; P= Përputhje e pjesëshme; N= Mos përputhje

## TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

Vendi Aderues: Shqipëria

<b>DIREKTIVË 2012/28/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, DATË 25.10.2012, "PËR PËRDORIME TË CAKTUARA TË LEJUARA TË VEPRAVE PA AUTOR"</b>  <b>(Tekst i cili lidhet me ZEE)</b>		Legjislacioni i Vendit Aderues  <b>LIGJI Nr. 35 / 2016 MBI TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E LIDHURA ME TË</b>				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Përmbajtja	Përputhshmeria	Shënime

	<p>prodhuesi i të cilave është me seli ose me vendbanim të zakonshëm në një nga shtetet anëtare, rast në të cilin kërkimi i kujdesshëm kryhet në shtetin anëtar të selisë ose të vendbanimit të tij të zakonshëm.</p> <p>Në rastin e përmendur në nenin 1, paragrafi 3, kërkimi i kujdesshëm kryhet në shtetin anëtar ku ndodhet ofruesi i shërbimit mediatik që ka vënë veprën ose fonogramin në akses publik me miratim të titullarit.</p> <p>4. Nëse ka evidenca që lënë të kuptohet se informacioni mbi titullarët mund të gjendet në shtete të tjera, duhen shfrytëzuar dhe këto burime në shtetet e tjera.</p> <p>5. Shtetet anëtare sigurojnë që ofruesit e shërbimit mediatik të përmendur në nenin 1, paragrafi 1 të ruajnë regjistra të kërkimeve të tyre të kujdesshme, dhe që këta ofrues të shërbimit mediatik të dorëzojnë informacionet e mëposhtme tek autoritetet kompetente kombëtare:</p> <p>a) rezultatet e kërkimeve të kujdesshme të kryera nga ofruesit e</p>			<p>bazave të të dhënave bibliografike të mbajtura nga bibliotekat dhe institucionet e tjera;</p> <p>ii. bazat e të dhënave dhe dokumentacioni i mbajtur nga institucionet arkivore, shoqatat e botuesve dhe autorëve në Republikën e Shqipërisë;</p> <p>iii. bazat e të dhënave ekzistuese dhe regjistrat nga shkrimtarët, artistët dhe mbajtësit e tyre të të drejtave së autorit, ISBN (International Standard Book Number) dhe bazat e të dhënave që listojnë libra për printim;</p> <p>iv. bazat e të dhënave dhe dokumentacioni i agjencive përkatëse të administrimit kolektiv, në veçanti agjencia e administrimit kolektiv për të drejtat e riprodhimit;</p> <p>v. burime që integrojnë bazat e të dhënave dhe regjistrave të shumëfishtë, duke përfshirë Bibliotekën Botërore Digjitale (World Digital Library) dhe Regjistrat e të Drejtave të Informacionit dhe Veprave pa Autor – ARROW) si dhe Portalin Online Europeana.</p> <p>vi. burime që tregojnë bazat e të dhënave, informacion dhe koleksione nga organizata dhe autoritete ndërkombëtare partnere të bibliotekave.</p> <p>b) Për gazetatat, revistat, ditaret dhe periodikët:</p> <p>i. ISSN (International Standard Serial Number)</p>		
--	--	--	--	--	--	--

A = Neni; P= Paragrafi; S= Fjalja; N= Numri;  
 F= Përputhje e plotë; P= Përputhje e pjesëshme; N= Mos përputhje

## TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

Vendi Aderues: Shqipëria

<b>DIREKTIVË 2012/28/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, DATË 25.10.2012, "PËR PËRDORIME TË CAKTUARA TË LEJUARA TË VEPRAVE PA AUTOR"</b>  <b>(Tekst i cili lidhet me ZEE)</b>		Legjislacioni i Vendet Aderues  <b>LIGJI Nr. 35 / 2016 MBI TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E LIDHURA ME TË</b>				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Përmbajtja	Përputh shmeria	Shënime

	<p>shërbimit mediatic sipas të cilave u arrit në përfundimin se vepra ose fonogrami konsiderohet vepër pa autor;</p> <p>b) përdorimin që i bëjnë ofruesit e shërbimit mediatic veprave pa autor në përputhje me direktivën;</p> <p>c) çdo ndryshim, në përputhje me nenin 5, të statusit si vepër pa autor për veprat dhe fonogramet që përdorin ofruesit e shërbimit mediatic;</p> <p>ç) informacionin përkatës të kontaktit të ofruesve të shërbimit mediatic përkatës.</p> <p>6. Shtetet anëtare marrin masat e nevojshme për të siguruar që informacioni i përmendur në paragrafin 5 të regjistrohet në një databazë të vetme me akses publik në internet të ngritur dhe të administruar nga zyra për harmonizimin e tregut të brendshëm (këtu "Zyra") në përputhje me Rregulloren (BE) nr. 386/2012. Për këtë qëllim, ato ia përcjellin informacionin Zyrës pa vonesë në çastin që e marrin nga ofruesit e shërbimit mediatic të përmendur në nenin1, paragrafi 1.</p>			<p>për botime periodike;</p> <p>ii. indekset dhe katalogët nga fondet bibliotekare dhe koleksionet;</p> <p>iii. depozitimet e kopjeve të detyruara, në veçanti nga bibliografite kombëtare të vecanta;</p> <p>iv. bazat e të dhënave dhe dokumentacioni i mbajtur nga institucionet arkivore, nga shoqatat e botuesve, autorëve dhe gazetarëve në Republikën e Shqipërisë;</p> <p>v. bazat e të dhënave dhe dokumentacioni i agjencive përkatëse të administrimit kolektiv, në veçanti agjencia e administrimit kolektiv për të drejtat e riprodhimit;</p> <p>vi. leksionet biografike;</p> <p>c) Për veprat e artit pamor, përfshirë artet e bukura, fotografinë, ilustrimin, dizajnin, arkitekturën, skicat, krijimet hartografike:</p> <p>i. burimet e referuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni;</p> <p>ii. bazat e të dhënave dhe dokumentacioni i agjencive përkatëse të administrimit kolektiv, në veçanti agjencia e administrimit kolektiv për veprat e arteve pamore dhe ajo për të drejtat e riprodhimit;</p>		
--	---	--	--	---	--	--

A = Neni; P= Paragrafi; S= Fjalja; N= Numri;

F= Përputhje e plotë; P= Përputhje e pjesëshme; N= Mos përputhje



## TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

Vendi Aderues: Shqipëria

<b>DIREKTIVË 2012/28/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, DATË 25.10.2012, "PËR PËRDORIME TË CAKTUARA TË LEJUARA TË VEPRAVE PA AUTOR"</b>  (Tekst i cili lidhet me ZEE)		Legjislacioni i Vendit Aderues  <b>LIGJI Nr. 35 / 2016 MBI TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E LIDHURA ME TË</b>				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Përmbajtja	Përputh shmeria	Shënime

				iii. sipas rastit, bazat e të dhënave të organizatave dhe institucioneve arkivore dhe të fotografisë.  d) Për veprat audiovizuale, shfaqjet, veprat e vendosura në fonograme dhe videograme:  i. Depozitim ligjor;  ii. bazat e të dhënave dhe dokumentacioni i mbajtur nga agjencitë kolektive të prodhuesve në Republikën e Shqipërisë;  iii. bazat e të dhënave dhe dokumentacioni i institucioneve arkivore filmike ose audiovizuale dhe bibliotekave kombëtare;  iv. bazat e të dhënave me standardet përkatëse dhe identifikues si mund të jetë Standardi Ndërkombëtar Audiovizual për materialin audioviziv, Kodi Ndërkombëtar i Veprës Muzikore për veprat muzikore dhe Kodi Ndërkombëtar i Regjistrimit Standard për fonograme;  v. bazat e të dhënave dhe dokumentacioni i agjencive përkatëse të administrimit kolektiv, në veçanti për autorët, interpretuesit, prodhuesit e fonogramit dhe prodhuesit audiovizualë;  vi. shënime dhe informacione të tjera që paraqiten në materialin e veprës ose në lëndën e paketimit të të drejtave të lidhura;		
--	--	--	--	--	--	--

A = Neni; P= Paragrafi; S= Fjalja; N= Numri;

F= Përputhje e plotë; P= Përputhje e pjesëshme; N= Mos përputhje

## TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

Vendi Aderues: Shqipëria

<b>DIREKTIVË 2012/28/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, DATË 25.10.2012, "PËR PËRDORIME TË CAKTUARA TË LEJUARA TË VEPRAVE PA AUTOR"</b>  (Tekst i cili lidhet me ZEE)		Legjislacioni i Vendit Aderues  <b>LIGJI Nr. 35 / 2016 MBI TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E LIDHURA ME TË</b>				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Përmbajtja	Përputh shmeria	Shënime

				<p>vii. bazat e të dhënave dhe dokumentacioni i organizatave të tjera përkatëse që përfaqësojnë një kategori të veçantë të mbajtësve të të drejtave.</p> <p>2. Një kërkim shterues kryhet nëse vepra është botuar për herë të parë ose, në mungesë të botimit, transmetuar për herë të parë në Republikën e Shqipërisë. Një kërkim shterues për veprat kinematografike dhe veprat e tjera audiovizive do të kryhet, nëse prodhuesi i filmit ka selinë e tij kryesore te biznesit ose vendbanimin e përhershëm në Republikën e Shqipërisë. Një kërkim shterues për veprat e parashikuara në nenin 16/1, pika 3, germa “c”, e këtij ligji kryhet nëse OSHMA-ja që i ka bërë ato publike me pëlqimin e autorit ose mbajtësit e tjerë të së drejtës ka selinë e saj në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>3. Institucionet e parashikuara në pikën 16/2, të këtij neni duhet të mbajnë evidenca dhe të dhëna për kërkimet shteruese të kryera. Informacioni që duhet të përmbajnë këto evidenca dhe të dhëna do t'i komunikohet Drejtorisë për të Drejtën e Autorit.</p> <p>4. Drejtoria për të Drejtën e Autorit, krijon, regjistron dhe administron bazën e të dhënave të vetme publike online, të veprave pa autor, të cilat kur lind nevoja i përcillen organeve kompetente të huaja.</p> <p>5. Evidencat dhe të dhënat e referuara në pikën 3 dhe 4 të këtij neni duhet të përfshijnë të paktën</p>		
--	--	--	--	---	--	--

A = Neni; P= Paragrafi; S= Fjalja; N= Numri;  
 F= Përputhje e plotë; P= Përputhje e pjesëshme; N= Mos përputhje

## TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

Vendi Aderues: Shqipëria

<b>DIREKTIVË 2012/28/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, DATË 25.10.2012, "PËR PËRDORIME TË CAKTUARA TË LEJUARA TË VEPRAVE PA AUTOR"</b>  (Tekst i cili lidhet me ZEE)		Legjislacioni i Vendit Aderues  <b>LIGJI Nr. 35 / 2016 MBI TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E LIDHURA ME TË</b>				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Përmbajtja	Përputhshmeria	Shënime

				informacionin e mëposhtëm: a) rezultatet e kërkimeve shteruese që kanë kryer këto institucione dhe të cilat kanë çuar në përfundimin se veprat ose lëndët që paketojnë të drejtat e lidhura konsiderohen respektivisht vepra pa autor ose lëndë që paketon të drejtat e lidhura. b) përdorimi që këto institucione bëjnë për veprat pa autor ose lëndët që paketojnë të drejtat e lidhura në pajtim me nenin 75/1 të këtij ligji; c) çdo ndryshim në statusin e veprave pa autor ose lëndët që paketojnë të drejtat e lidhura që përdoren nga institucionet; d) informacionin përkatës të kontaktit të institucionit në fjalë.		
<b>A 4</b>	<b>Njohja e përbashkët e statusit si vepër pa autor</b>  Një punë ose fonogram që konsiderohet vepër pa autor në përputhje me nenin 2 në një shtet anëtar, konsiderohet vepër pa autor në të gjitha shtetet anëtare. Vepra ose fonogrami mund të përdoret dhe shfrytëzohet në përputhje me këtë direktivë nga të gjitha shtetet anëtare. Kjo vlen gjithashtu për veprat dhe fonogramet e përmendura në	<b>A 16/1</b>	<b>Veprat pa autor</b>	7. Një vepër që konsiderohet vepër pa autor në përputhje me ligjin e çdo shteti anëtar të Bashkimit Evropian do të konsiderohet gjithashtu një vepër pa autor edhe në Republikën e Shqipërisë, pa qenë nevoja për të kryer procedurën e kërkimit shterues, të parashikuar në nenin 16/2 të këtij ligji. E njëjta gjë do të zbatohet mutatis mutandis për veprat e bashkëautorëve të cilat janë krijuar në një shtet tjetër	<b>Plotë</b>	

A = Neni; P= Paragrafi; S= Fjalë; N= Numri;

F= Përputhje e plotë; P= Përputhje e pjesëshme; N= Mos përputhje

## TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

Vendi Aderues: Shqipëria

<b>DIREKTIVË 2012/28/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, DATË 25.10.2012, "PËR PËRDORIME TË CAKTUARA TË LEJUARA TË VEPRAVE PA AUTOR"</b>  (Tekst i cili lidhet me ZEE)		Legjislacioni i Vendit Aderues  <b>LIGJI Nr. 35 / 2016 MBI TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E LIDHURA ME TË</b>				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Përmbajtja	Përputhshmeria	Shënime

	nenin 2, paragrafi 2 për sa u përket të drejtave të titullarëve të paidentifikuar dhe të papikasur.			anëtar të Bashkimit Evropian dhe gëzojnë statusin “Vepër pa autor”, sepse jo të gjithë bashkëautorët janë identifikuar apo u dihet vendndodhja, vetëm në lidhje me pjesët e tyre takuese.		
<b>A 5</b>	<b>Përfundimi i statusit si vepër pa autor</b>  Shtetet anëtare sigurojnë që titullari i një veprë apo fonogrami që konsiderohet si vepër pa autor gëzon në çdo kohë mundësinë që t'i japë fund statusit si vepër pa autor, për sa u përket të drejtave të tij.		<b>A 16/1</b>	<b>Veprat pa autor</b>  6. Autori ose bashkëautori i veprës, që sipas pikave 1 deri në 5 të këtij neni konsiderohet një vepër pa autor, në çdo kohë, mund të përfundojë, statusin të veprës pa autor në lidhje me të drejtat e tij.	<b>Plotë</b>	
<b>A 6</b>	<b>Përdorimet e lejuara për veprat pa autor</b>  1. Shtetet anëtare parashikojnë përjashtimin ose kufizimin e së drejtës të riprodhimit dhe të vënies në dispozicion të publikut, të parashikuar përkatësisht në nenet 2 dhe 3 të Direktivës 2001/29/KE për të siguruar që ofruesit e shërbimit mediatic të përmendur në nenin 1, paragrafi 1, të përdorin veprat pa autor të përmbajtura në koleksionet e tyre në mënyrat e mëposhtme:  a) duke e vënë veprën pa autor në dispozicion të publikut sipas kuptimit		<b>A 75/1</b>	<b>Përdorimi pa kufizim i veprave pa autor</b>  1. Bibliotekat publike, institucionet arsimore ose muzetë, personat e tjerë juridikë që kryejnë veprimtari muzeore, arkivat, institucioneve arkivore filmike ose audiovizuale dhe Ofruesit e shërbimit mediatic audiovisual (OSHMA-t) që janë krijuar në Republikën e Shqipërisë mund të riprodhojnë vepra pa autor që janë të përfshira në koleksionet e tyre për qëllime të dixhitalizimit, si dhe duke i vendosur ato në dispozicion të publikut, të indeksuara, kataloguara, ruajtura ose restauruara.	<b>Pjesërisht</b>	<i>Pikat 1 - 4 të këtij neni të Direktivës janë plotësisht të përfruar.</i>  <i>Ndërkohë për zbatimin e pikës 5 të këtij neni, njihet e drejta e kompensimit të drejtë për titullarët që përfundojnë statusin e veprës pa autor,</i>

A = Neni; P= Paragrafi; S= Fjalja; N= Numri;

F= Përputhje e plotë; P= Përputhje e pjesëshme; N= Mos përputhje

## TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

Vendi Aderues: Shqipëria

<b>DIREKTIVË 2012/28/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, DATË 25.10.2012, "PËR PËRDORIME TË CAKTUARA TË LEJUARA TË VEPRAVE PA AUTOR"</b>  <b>(Tekst i cili lidhet me ZEE)</b>		Legjislacioni i Vendit Aderues  <b>LIGJI Nr. 35 / 2016 MBI TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E LIDHURA ME TË</b>				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Përmbajtja	Përputhshmeria	Shënime

	<p>të nenit 3 të Direktivës 2001/29/KE;</p> <p>b) përmes akteve të riprodhimit, sipas kuptimit të nenit 2 të Direktivës 2001/29/KE, për qëllime të dixhitalizimit, vënies në dispozicion, indeksimit, katalogimit, ruajtjes ose restaurimit.</p> <p>2. Ofruesit e shërbimit mediatic të përmendur në nenin 1, paragrafi 1 e përdorin veprën pa autor në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, për të arritur synimet në lidhje me misionet e tyre në interes të publikut, sidomos për ruajtjen, restaurimin dhe sigurimin e aksesit kulturor dhe arsimor ndaj veprave dhe fonogrameve që bëjnë pjesë në koleksionin e tyre. Ofruesit e shërbimit mediatic mund krijojnë të ardhura gjatë këtyre përdorimeve, për qëllim ekskluziv të mbulimit të kostove të tyre për dixhitalizimin e veprave pa autor dhe për vënien e tyre në dispozicion të publikut.</p> <p>3. Shtetet anëtare sigurojnë që ofruesit e shërbimit mediatic të përmendur në nenin 1, paragrafi 1 të tregojnë emrin e autorëve të identifikuar dhe të titullarëve të tjerë në çdo</p>			<p>2. Institucionet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, mund të kryejnë riprodhimin e këtyre veprave dhe t'i vendosin në dispozicion të publikut vetëm për të arritur qëllimet që kanë të bëjnë me misionet e tyre me interes publik, në veçanti, ruajtjen, restaurimin dhe sigurimin e aksesit kulturor dhe arsimor për veprat pa autor të përfshira në koleksionet e tyre.</p> <p>3. Institucionet e përmendura në pikën 1, të këtij neni mund të përfitojnë të ardhura gjatë përdorimeve të tilla të veprave pa autor, për qëllimin e vetëm të mbulimit të kostove të tyre të digjitalizimit dhe t'i vendosë ato në dispozicion të publikut. Ky parashikim nuk ndikon në lirinë kontraktore të këtyre institucioneve për ndjekjen e misioneve të tyre të interesit publik, veçanërisht në lidhje me marrëveshjet e partneritetit publik-privat.</p> <p>4. Në çdo rast të përdorimit të një vepre pa autor, institucionet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, duhet të tregojnë, respektivisht autorin e identifikuar dhe bashkëautorët e këtyre veprave, për rastin e autorit</p>		<p><i>për përdorimin e veprës gjatë kohës që ka patur këtë status, por zbatimi dhe dhënia e këtij kompensimi kushtëzohet me anëtarësimin e vendit tonë në BE.</i></p>
--	---	--	--	--	--	---

A = Neni; P= Paragrafi; S= Fjalja; N= Numri;

F= Përputhje e plotë; P= Përputhje e pjesëshme; N= Mos përputhje

## TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

Vendi Aderues: Shqipëria

<p><b>DIREKTIVË 2012/28/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, DATË 25.10.2012, "PËR PËRDORIME TË CAKTUARA TË LEJUARA TË VEPRAVE PA AUTOR"</b></p> <p>(Tekst i cili lidhet me ZEE)</p>		Legjislacioni i Vëndit Aderues				
		<p><b>LIGJI Nr. 35 / 2016 MBI TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E LIDHURA ME TË</b></p>				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Përmbajtja	Përputh shmeria	Shënime

	<p>përdorim të veprës pa autor.</p> <p>4. Direktiva nuk cenon lirinë e lidhjes së kontratave për këta ofrues të shërbimit mediatic në ndjekje të misionëve të tyre në interes të publikut, sidomos për sa i përket marrëveshjeve të partneritetit publik-privat.</p> <p>5. Shtetet anëtare parashikojnë kompensim të drejtë për titullarët që përfundojnë statusin si vepër pa autor të veprave dhe të materialeve të tjera të mbrojtura të tyre për përdorimin që i është bërë nga ofruesit e shërbimit mediatic të përmendur në nenin 1, paragrafi 1 të këtyre veprave dhe materialeve të tjera të mbrojtura në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni. Shtetet anëtare kanë lirinë të përcaktojnë rrethanat sipas të cilave organizohet pagesa e këtij kompensimi. Shkalla e kompensimit përcaktohet, brenda kufizimeve të caktuara nga ligji i Bashkimit Evropian, nga ligji i shtetit anëtar ku ndodhet ofruesi i shërbimit</p>	<p>A 75/1</p> <p>A 75/2</p>	<p>që nuk i dihet vendndodhja.</p> <p>3. Institucionet e përmendura në pikën 1, të këtij neni mund të përfitojnë të ardhura gjatë përdorimeve të tilla të veprave pa autor, për qëllimin e vetëm të mbulimit të kostove të tyre të digjitalizimit dhe t'i vendosë ato në dispozicion të publikut. Ky parashikim nuk ndikon në lirinë kontraktore të këtyre institucioneve për ndjekjen e misionëve të tyre të interesit publik, veçanërisht në lidhje me marrëveshjet e partneritetit publik-privat.</p> <p><b>E drejta e kompensimit për përdorimin e veprës pa autor</b></p> <p>1. Autori ose bashkëautori, i cili vendos të përfundojë statusin e veprës pa autor sipas parashikimit të pikës 6, të nenit 16/1, të këtij ligji, gëzon të drejtën për kompensim të drejtë për përdorimin që i është bërë veprës së tij nga institucioni përkatës i parashikuar në nenit 75/1 të këtij ligji, që ka përdorur veprën.</p> <p>2. Shuma e kompensimit e parashikuar në pikën 1, të këtij neni do të përcaktohet sipas kategorive të veprave pa autor, duke marrë parasysh, ndër të tjera, qëllimet e promovimit kulturor, natyra jo fitimprurëse e përdorimit të bërë nga institucioni përkatës, qëllimet që kanë të bëjnë me misionet e tyre me interes publik, të tilla si promovimi i mësimnxënies dhe përharjes së</p>		
--	---	-----------------------------	--	--	--

A = Neni; P= Paragrafi; S= Fjalja; N= Numri;  
F= Përputhje e plotë; P= Përputhje e pjesëshme; N= Mos përputhje

## TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

Vendi Aderues: Shqipëria

DIREKTIVË 2012/28/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, DATË 25.10.2012, "PËR PËRDORIME TË CAKTUARA TË LEJUARA TË VEPRAVE PA AUTOR"  (Tekst i cili lidhet me ZEE)		Legjislacioni i Vendit Aderues				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Përmbajtja	Përputh shmeria	Shënime
	mediatik që përdor veprën pa autor në fjalë.		A 187	<p>kulturës, si dhe dëmet e mundshme që mund t’iu shkaktohen autorëve. Kompensimi i drejtë paguhet në mënyrë prapavepruese pas përdorimit të veprës, jo më shumë se tre vjet nga dita e përfundimit të statusit të veprës pa autor.</p> <p>3. Kërkesa për pagesën e një kompensimi të drejtë mund të paraqitet nga autori ose agjencia përkatëse e administrimit kolektiv, e autorizuar nga autori për paraqitjen e kësaj kërkesë. Kërkesa për pagesën e një kompensimi të drejtë i nënshtrohet statutit të kufizimeve, duke llogaritur nga dita e mbarimit të statusit të veprave pa autor.</p> <p><b>4. Procedura dhe mënyra e kompesimit të drejtë për përdorimin e veprës pa autor, në zbatim të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrive.</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Procedurat në proces</b></p> <p>5. Pika 8, e nenit 32, si dhe <i>pika 4 e neni 75/2, të këtij ligji, zbatohen në datën e hyrjes së Shqipërisë në Bashkimin European.</i></p>		
A 7	Zbatimi i vazhduar për dispozita të tjera ligjore  Direktiva nuk cenon dispozitat,		A 75/2	E drejta e kompesimit për përdorimin e veprës pa autor  5. Dispozitat e këtij neni nuk do të ndikojnë në	Plotë	

A = Neni; P= Paragrafi; S= Fjalja; N= Numri;

F= Përputhje e plotë; P= Përputhje e pjesëshme; N= Mos përputhje

## TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

Vendi Aderues: Shqipëria

<b>DIREKTIVË 2012/28/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, DATË 25.10.2012, "PËR PËRDORIME TË CAKTUARA TË LEJUARA TË VEPRAVE PA AUTOR"</b>  <b>(Tekst i cili lidhet me ZEE)</b>		Legjislacioni i Vendet Aderues  <b>LIGJI Nr. 35 / 2016 MBI TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E LIDHURA ME TË</b>				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Përmbajtja	Përputh shmeria	Shënime

	sidomos ato në lidhje me të drejtat e patentës, markat tregtare, të drejtat e disenjimit, modelet e shërbimit, topografite e produkteve gjysmëpërçuese, llojet e shkrimeve, aksesin e kushtëzuar, aksesin në kabllot e shërbimeve transmetuese, mbrojtjen e pasurive kombëtare, kërkesat për depozita ligjore, ligjet mbi praktikat kufizuese dhe konkurrencën e padrejtë, sekretet tregtare, sigurinë, konfidencialitetin, mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë, aksesin në dokumente publike, ligjin e kontratës dhe rregullat mbi lirinë e shtypit e të shprehjes në media.			të drejtat dhe detyrimet e fituara nga dispozitat tjera ligjore në lidhje me të drejtat e tjera të pronësisë intelektuale, aksesin e kushtëzuar, aksesin në shërbimet e transmetimit me kabëll, mbrojtjen e thesareve kombëtare, kërkesat për depozitimet, arkivimet ligjore të veprave, mbrojtja e tregtinë së lire, ligjet antitrust, sekretet tregtare, sigurinë, konfidencialitetin, mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë, aksesin në dokumente publike, legjislacionin përkatës për marrëdhëniet kontraktuale dhe rregullat për lirinë e shtypit dhe shprehjes në media.		
<b>A 8</b>	<b>Zbatimi në kohë</b>  1. Direktiva zbatohen në lidhje me të gjitha veprat dhe fonogramet e përmendura në nenin 1, të cilat mbrohen nga legjislacioni i shteteve anëtare në fushën e të drejtave të autorit më 29 tetor 2014 ose më mbrapa.  2. Direktiva zbatohet pa paragjykim ndaj çdo akti të përfunduar dhe të drejtave të përfuara përpara 29		<b>A 187/1</b>	<b>Zbatimi në kohë i veprave pa autor</b>  Dispozitat për veprat pa autor të parashikuara në këtë ligj do të zbatohen pa cënuar kalimet e të drejtave ose të drejtat e fituara përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.	<b>Plotë</b>	

A = Neni; P= Paragrafi; S= Fjalja; N= Numri;  
 F= Përputhje e plotë; P= Përputhje e pjesëshme; N= Mos përputhje



## TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

Vendi Aderues: Shqipëria

<b>DIREKTIVË 2012/28/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, DATË 25.10.2012, "PËR PËRDORIME TË CAKTUARA TË LEJUARA TË VEPRAVE PA AUTOR"</b>  <b>(Tekst i cili lidhet me ZEE)</b>		Legjislacioni i Vendit Aderues  <b>LIGJI Nr. 35 / 2016 MBI TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E LIDHURA ME TË</b>				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Përmbajtja	Përputh shmeria	Shënime

	tetorit 2014.					
<b>A 9</b>	<p style="text-align: center;"><b>Transpozimi</b></p> <p>1. Shtetet anëtare miratojnë ligjet, rregulloret dhe dispozitat e nevojshme administrative për t'u pajtuar me këtë direktivë deri më 29 tetor 2014. Ato i komunikojnë menjëherë Komisionit tekstin e këtyre dispozitave.</p> <p>Kur shtetet anëtare i miratojnë këto dispozita, ato përmbajnë një referencë ndaj kësaj direktive ose shoqërohen nga një referencë e tillë me rastin e botimit zyrtar të tyre. Mënyrat për bërjen e një reference të tillë përcaktohen nga vetë shtetet anëtare.</p> <p>2. Shtetet anëtare i komunikojnë Komisionit tekstin e dispozitave kryesore të legjislacionit kombëtar që ato miratojnë në fushën që mbulohet nga kjo direktivë.</p>					<i>Vetëm për vendet anëtare</i>
<b>A 10</b>	<p style="text-align: center;"><b>Klauzola e rishikimit</b></p> <p>Komisioni mban nën shqyrtim të vazhdueshëm zhvillimin e burimeve të informacionit mbi të drejtat dhe, deri më 29 tetor 2015 e më pas në intervale vjetore, dërgon një raport në lidhje me</p>					<i>Vetëm për vendet anëtare</i>

A = Neni; P= Paragrafi; S= Fjalja; N= Numri;  
F= Përputhje e plotë; P= Përputhje e pjesëshme; N= Mos përputhje

## TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

Vendi Aderues: Shqipëria

<b>DIREKTIVË 2012/28/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, DATË 25.10.2012, "PËR PËRDORIME TË CAKTUARA TË LEJUARA TË VEPRAVE PA AUTOR"</b>  <b>(Tekst i cili lidhet me ZEE)</b>		Legjislacioni i Vendit Aderues  <b>LIGJI Nr. 35 / 2016 MBI TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E LIDHURA ME TË</b>				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Përmbajtja	Përputh shmeria	Shënime

	<p>përfshirjen e mundshme në fushën e zbatimit të direktivës, të botuesve dhe veprave ose materialeve të tjera të mbrojtura që nuk përfshihen aktualisht në fushën e zbatimit, dhe sidomos fotot dhe imazhet e mëvetësishme.</p> <p>Deri më 29 tetor 2015 Komisioni i paraqet Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komitetit Evropian Ekonomik dhe Shoqëror një raport për zbatimin e kësaj Direktive, në këndvështrimin e zhvillimit të bibliotekave dixhitale.</p> <p>Kur është e nevojshme, sidomos për garantimin e funksionimit të tregut të brendshëm, Komisioni dërgon propozimet për ndryshimet e kësaj direktive.</p> <p>Shteti anëtar me arsye të vlefshme për të menduar se zbatimi i direktivës pengon një prej masave kombëtare në lidhje me administrimin e të drejtave të përmendura në nenin 1, paragrafi 5, mund ta sjellë çështjen në vëmendje të Komisionit, së bashku me të gjithë provat e rëndësishme. Komisioni i merr parasysh këto prova gjatë hartimit të raportit të përmendur në paragrafin e</p>					
--	--	--	--	--	--	--

A = Neni; P= Paragrafi; S= Fjalja; N= Numri;  
 F= Përputhje e plotë; P= Përputhje e pjesëshme; N= Mos përputhje

## TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

Vendi Aderues: Shqipëria

<b>DIREKTIVË 2012/28/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, DATË 25.10.2012, "PËR PËRDORIME TË CAKTUARA TË LEJUARA TË VEPRAVE PA AUTOR"</b>  (Tekst i cili lidhet me ZEE)		Legjislacioni i Vendit Aderues  <b>LIGJI Nr. 35 / 2016 MBI TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E LIDHURA ME TË</b>				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Përmbajtja	Përputh shmeria	Shënime

	dytë të këtij neni dhe gjatë vlerësimit të domosdoshmërisë së dërgimit të propozimeve për ndryshimin e kësaj direktive.					
<b>A 11</b>	<b>Hyrja në fuqi</b>  Kjo direktivë hyn në fuqi ditën vijuese pas botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.					<i>Vetëm për vendet anëtare</i>
<b>A 12</b>	<b>Marrësit</b>  Kjo direktivë u drejtohet shteteve anëtare.					<i>Vetëm për vendet anëtare</i>

A = Neni; P= Paragrafi; S= Fjalja; N= Numri;  
F= Përputhje e plotë; P= Përputhje e pjesëshme; N= Mos përputhje